

1. Informacion i përgjithshëm

“Hydro Seta” sh.p.k (Kompania) është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më 28 mars 2013 në përputhje me Ligjin nr. 9901, date 14.04.2008 “Mbi Shoqëritë tregtare” me NIPT L31528016T.

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 100,000 Lekë dhe zotërohet nga ortakët:

- KUPA shpk 8.6%
- KALIA shpk 3.0%
- 2 L&M shpk 3.0%
- Liqeni VII sh.a 10.90%
- ALB-BUILDING shpk 74.50%

Ndërtimi, operimi dhe transferimi i hidrocentraleve “Seta 2-1”, “Seta 2-2”, “Seta 3”, “Seta 4” te Autoriteti Kontraktor, ku përfshihet Financimi, ndërtimi, vënia në punë, prodhimi, furnizimi, transmetimi, shpërndarja, eksportimi dhe shitja e energjisë elektrike në zbatim të kontratës së koncensionit Nr. 67 Rep., Nr. 19 Kol., datë 01.02.2013.

Numri i punonjësve në 31 dhjetor 2019 është 35 punonjës.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare**2.1. Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)**2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme**

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahueshmëria e informacionit kontabël

Kur është e nevojshme, shifrat krahasuese axhustohen (rregullohen) në konform me ndryshimet në paraqitje në periudhën aktuale raportuese. Ndryshimet janë kryer për të paraqitur më mirë natyrën e biznesit të Shoqërisë. Ato aplikohen retrospektivisht.

3. Politikat kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Euro/LEK	121.77	123.42
USD/ LEK	108.64	107.82

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

3. Politikat kontabël (vazhdim)**3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)***Zhvlerësimi i aktiveve financiare*

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivët e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale*i. Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundur që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

3. Politikat kontabël (vazhdim)**3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)***iii. Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitet afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitet.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2019 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20%
Mobilje dhe pajisje zyre	Vlera e mbetur	20%
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25%
Të tjera	Vlera e mbetur	20%

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Aktivet Afatgjata Jomateriale

Një aktiv jo-material njihet nëqoftëse, e vetëm nëqoftëse:

është e mundshme që përfitimet e pritshme ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij aktiv do të rrjedhin tek njësia ekonomike; dhe kosto e aktivitet mund të matet me besueshmëri.

Një njësi ekonomike vlerëson mundësinë e përfitimeve të pritshme ekonomike në të ardhmen duke përdorur supozime të arsyeshme dhe të mbështetura që përfaqësojnë vlerësimin më të mirë të drejtimit të kompletit të kushteve ekonomike që do të ekzistojnë gjatë jetës së dobishme të aktivitet.

Njësia ekonomike përdor gjykimin për të vlerësuar shkallën e sigurisë bashkëngjitur flukseve të përfitimeve ekonomike në të ardhmen që i atribuohen përdorimit të aktivitet mbi bazën e evidencës së disponueshme në kohën e njohjes fillestare, duke i dhënë më shumë rëndësi evidencës nga të tretët.

Një aktiv jo-material matet fillimisht me koston.

Mbajtja e mëpasshme

Mbas njohjes fillestare, një aktiv jo-material mbartet me koston e tij minus çdo amortizim të akumuluar dhe çdo humbje të akumuluar nga zhvëlësimi.

Aktivitet jo-materiale të krijuara nga marrëveshja koncesionare janë amortizuar në bazë të periudhës koncesionare.

3.5.1 Marrëveshjet Koncesionare

Një marrëveshje koncesionare e shërbimeve është një marrëveshje ku një qeveri ose një organ tjetër i sektorit publik (koncesiondhënësi) kontraktin një operator privat për të ndërtuar(ose përmirësuar), përdorur dhe mirëmbajtur aktivitet e infrastrukturës së koncesiondhënësit si rrugë, ura, tunele, aeroporte, rrjete të shpërndarjes së energjisë, burgje apo spitale. Në këto marrëveshje, koncesiondhënësi kontrollon ose rregullon çfarë shërbimesh duhet të ofrojë operatori duke përdorur aktivitet, kujt duhet t'ia sigurojë dhe me çfarë çmimi, dhe gjithashtu kontrollon çdo interes të mbetur domethënë në aktive në fund të afatit të marrëveshjes. Shoqëria ka njohur aktivitet e krijuara nga marrëveshja koncesionare sipas modelit të Aktivitet Jomaterial.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.5.1 Marrëveshjet Konçesionare (vazhdim)

Operatori duhet të njohë një aktiv jo-material në masën që i jep atij të drejtën (liçensën) për t'i tarifuar përdoruesve të shërbimit publik. Operatori duhet fillimisht të masë aktivin jo-material me vlerën e drejtë. Më tej për kontabilizimin e aktivit jomaterial, operatori duhet të zbatojë kërkesat e SKK 5 Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale.

3.6. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

Shoqëria i njeh të ardhurat kur prodhon energjinë.

3.7. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.8. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve. Shoqëria ka vetëm qira operative.

3.9. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.10. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 15% (2018: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka burim diferencash të përkohshme për njohjen e tatimi të shtyrë.

3. Politikat kontabël (vazhdim)**3.11. Fondet për pensione**

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.12. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.13. Aktivitetet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Vlerësimet kritike të kontabilitetit

Ndërsa situata pandemike COVID-19 ende po evoluon në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, menaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në kompani. Ndërsa masat kufizuese vazhdojnë, volumi i shitjeve, fluksi i parasë dhe fitimi mund të ndikohen. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, kompania po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare.

5. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Mjete monetare në bankë	40,334,578	9,637,609
Mjete monetare në arkë	222,972	6,856,321
	40,557,550	16,493,930

6. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Klientë	5,921,978	6,518,704
	5,921,978	6,518,704

7. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Paradhënie punonjësve	-	974,872
	<u>-</u>	<u>974,872</u>

8. Të ardhura të përlogaritura

Të ardhurat e përlogaritura më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Të ardhura të përlogaritura	58,117,430	-
	<u>58,117,430</u>	<u>-</u>

9. Inventarë

Inventari më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Materiale për instalim në vepër	1,099,299	285,359,587
Inventar i imët	646,365	11,287,874
	<u>1,745,664</u>	<u>296,647,461</u>

10. TVSH e arkëtueshme

TVSH e arkëtueshme detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
TVSH për t'u arkëtuar	318,202,755	323,941,101
TVSH për t'u arkëtuar nga dogana	175,904	192,894
	<u>318,378,659</u>	<u>324,133,995</u>

11. Parapagime dhe shpenzime të shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra paraqiten si më poshtë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Parapagime të dhëna për Aktivitet operativ	11,132,349	24,377,770
Detyrime tatimore të apeluara	-	36,008,978
Shpenzime të shtyra	-	1,872,270
	11,132,349	62,259,018

12. Aktive Afatgjata Materiale

	Makineri dhe Pajisje	Mjete transporti	Pajisje informatike	Totali
Kosto				
Gjendja më 1 janar 2018	22,539,941	7,662,359	1,404,343	31,606,643
Shtesa	6,751,540	-	559,726	7,311,266
Pakësime	-	-	(121,667)	(121,667)
Gjendja më 31 dhjetor 2018	29,291,481	7,662,359	1,842,402	38,796,242
Shtesa	19,458,373	-	1,227,577	20,685,950
Transferime	-	-	-	-
Pakësime	(731,500)	-	(25,000)	(756,500)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	48,018,354	7,662,359	3,044,979	58,725,692
Amortizimi i akumuluar				
Gjendja më 1 janar 2018	2,357,727	974,007	486,743	3,818,477
Amortizimi i vitit	4,356,686	1,059,900	888,770	6,305,356
Riklasifikim	-	-	(24,334)	(24,334)
Pakesime	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	6,714,413	2,033,907	1,351,179	10,099,499
Amortizimi i vitit	4,517,113	1,125,690	122,805	5,765,608
Riklasifikim	-	-	-	-
Pakësime	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	11,231,526	3,159,597	1,473,984	15,865,107
Vlera neto kontabël				
Gjendja më 31 dhjetor 2018	22,577,068	5,628,452	491,223	28,696,743
Gjendja më 31 dhjetor 2019	36,786,828	4,502,762	1,570,995	42,860,585

13. Aktive Afatgjata Materiale Jo Materiale

Kosto	HEC SETA 1	Totali
Gjendja më 1 janar 2018	-	-
Shtesa	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	-	-
Shtesa	2,234,624,715	2,234,624,715
Riklasifikim	-	-
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	2,234,624,715	2,234,624,715
<i>Amortizimi i akumuluar</i>		
Gjendja më 1 janar 2018	-	-
Amortizimi i vitit	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	-	-
Amortizimi i vitit	45,340,212	45,340,212
Riklasifikim	-	-
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	45,340,212	45,340,212
<i>Vlera neto kontabël</i>		
Gjendja më 31 dhjetor 2018	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	2,189,284,503	2,189,284,503

14. Aktive Afatgjata në proces

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Aktive afatgjata materiale në proces	-	1,759,901,948
	-	1,759,901,948

15. Parapagime dhe shpenzime të shtyra afatgjatë

Parapagime dhe shpenzimet të shtyra afatgjata më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Shpenzime të shtyra afatgjata	164,130,827	166,251,671
	<u>164,130,827</u>	<u>166,251,671</u>

16. Të pagueshme për shpenzime të konstatuara

Të pagueshme për shpenzime të konstatuara më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Interesa të përllogaritur	-	2,163,815
	<u>-</u>	<u>2,163,815</u>

17. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Furnitorë në lekë	296,907,027	332,463,470
Furnitorë në monedhë	45,572,132	50,902,445
	<u>342,479,159</u>	<u>383,365,915</u>

18. Të pagueshme ndaj punonjësve

Detyrimet e tjera paraqesin detyrimet ndaj punonjësve më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Paga të pagueshme	1,015,514	3,185,207
	<u>1,015,514</u>	<u>3,185,207</u>

19. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Tatimi mbi fitimin	788,822	7,373,772
Detyrime sigurime shoqërore dhe shëndetsore	314,679	913,129
Detyrime për tatimin mbi të ardhurat personale	30,358	60,224
	<u>1,133,859</u>	<u>8,347,125</u>

20. Hua Afatgjatë

Hua afatgjata më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Hua afatshkurtër-OTP Bank Albania	97,416,000	-
Hua afatgjatë- OTP Bank Albania	815,366,134	907,035,425
	<u>912,782,134</u>	<u>907,035,425</u>

21. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura afatgjatë

Llogaritë e pagueshme nga palët e lidhura afatgjata më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Detyrime ndaj ALB-building	1,503,137,612	1,284,562,556
Detyrime ndaj Kupa Shpk	75,000,000	67,000,000
Hua nga Liqeni VII sh.a	5,110,211	5,110,211
	<u>1,583,247,823</u>	<u>1,356,672,767</u>

22. Kapitali themeltar

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 100,000 Lekë dhe zotërohet nga ortakët:

- KUPA shpk 8.6%
- KALIA shpk 3.0%
- 2 L&M shpk 3.0%
- Liqeni VII sh.a 10.90%
- ALB-BUILDING shpk 74.50%

Fitimet e mbartura janë në vlerën 1,008,088 Lekë (2018: 1,008,088 Lekë)

23. Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Situacionet e punimeve-ndërtim i HEC	474,730,242	1,325,476,963
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	124,055,730	-
	<u>598,785,972</u>	<u>1,325,476,963</u>

24. Të ardhurat të tjera nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga shitja e materialeve	-	20,533,422
Të ardhura të tjera	2,597	661,690
	2,597	21,195,112

25. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndeve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen me veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Kosto materiale	385,137,362	1,060,245,798
Punime nga nenkontraktore	39,568,622	183,101,666
Tarifa konçesionit	3,725,771	-
Të tjera	215,000	2,289,943
	428,646,755	1,245,637,407

26. Shpenzime të tjera

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shpenzim mirëmbajtje	42,900,611	29,219,326
Energji elektrike	1,989,455	5,392,621
Shpenzime për personelin	15,298,081	18,363,600
Shpenzime bankare	598,667	1,550,782
Të tjera	20,103,422	9,547,953
	80,890,236	64,074,282

27. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shpenzime paga	18,959,003	33,516,854
Shpenzime për sigurime shoqërore	3,069,878	5,543,362
	22,028,881	39,060,216

28. Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi

Shpenzimet e amortizimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shpenzime amortizimi	51,105,820	6,305,356
	51,105,820	6,305,356

29. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjobat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Gjoba	25,669	3,889,977
	25,669	3,889,977

30. Shpenzime financiare neto

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit dhe shpenzime të tjera financiare. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Humbje nga këmbimet valutore	(3,340,711)	(47,956,204)
Fitime nga këmbime valutore	7,559,205	68,277,482
Shpenzime për interesa	(21,828,031)	(8,028,399)
Të ardhura nga interesa	12,208	2,284
	(17,597,329)	12,295,163

31. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
<i>Fitimi para tatimit</i>	(1,506,121)	-
Total shpenzime të panjohura	55,712,194	-
Penalitete, gjoba e dëmshpërblime	-	-
Shpenzime të tjera	55,712,194	-
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	54,206,073	-
Humbje fiskale e mbartur	-	-
Tatim fitimi @15%	8,130,911	-
	(9,637,032)	-

32. Angazhime dhe pasiguri*Çështje gjyqësore*

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 dhjetor 2019 shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në menyrë të besueshme.

33. Ngjarje pas bilancit

Më 11 Mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetit e deklaroi koronavirusin (COVID-19) një pandemi. Ndërsa situata është ende duke u zhvilluar në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Impakti financiar do të njihet nga Kompania gjatë vitit 2020. Menaxhimi do të vazhdojë të monitorojë ndikimin e mundshëm dhe do të ndërmarrë të gjitha hapat e mundshëm për të lehtësuar çdo efekt. Menaxhimi e konsideron këtë pandemi si një ngjarje që nuk rregullohet pas datës së raportimit dhe e ka shpalosur në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare. Efektet mbi bazën e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare janë shpalosur në shënimin 4 "Vlerësimet kritike të kontabilitetit" të këtyre pasqyrave financiare.

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.